



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

**VENDIM**

**Nr. 1, datë 29.01.2025**

**PËR**  
**MIRATIMIN E KALENDARIT TË PUNËS PËR VITIN 2025**  
**TË KËSHILLIT DREJTUES**  
**TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 5, shkronja “c”, të nenit 7, shkronja “a”, si dhe të nenit 10, pika 3 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, me propozim të Kryetarit, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kalendarit të punës për vitin 2025 të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen njësitë organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

